

RELACION

PROJEKTLIGJI “PER REFERENDUMET”

Referendumi është një nga format më përfaqësuese të demokracisë direkte nëpërmjet të cilit bëhet miratimi i një ligji të caktuar apo zgjidhja e një çështjeje të rëndësishme që luan rol në jetën e poullatës. Në këtë kontekst mund të themi se referendumi është një formë plebishitare e miratimit të ligjeve kur është e nevojshme tërheqja e mendimeve të të gjithë komunitetit.

Shtetet me demokraci të konsoliduar aplikojnë referendumin si një proces të nevojshëm dhe njëkohësisht transparent në vendmarrje të rëndësishme që lidhen më të ardhmen e shteteve të tyre. Zvicra është një nga shtetet shëmbull, ku e drejta referendare aplikohet në mënyrë sistematike e ndjekur edhe nga shumë shtete të tjera demokratike. Tashmë procesi i referendunit është një trend në rritje edhe përsa i përket shteteve të rajonit të ballkanit jugperëndimor, të cilat aspirojnë për konsolidimin e demokracisë së tyre ende në formësim.

Shqipëria ka aplikuar për herë të parë dhe të vetme referendumin për miratimin e Kushtetutës së Shqipërisë në vitin 1998. Kjo Kushtetutë e miratuar me referendum është baza themelore ligjore për hartimin e projektligjit “Për Referendumet”, që po propozohet bashkëlidhur këtij relacioni duke lejuar hartimin dhe miratimin e tij.

Ky projektligj vjen në mbështetje të:

Nenit 2 “Sovraniteti” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që konstituon faktin se populli e ushtron sovranitetin e tij jo vetëm nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur të tij por edhe në mënyrë individuale drejtpërdrejtë duke patur parasysh të drejtën e popullit për të votuar nëpërmjet referendumeve popullore për vendimmarrjet e rëndësishme kombëtare apo lokale.

Nenit 81, pika 1 “Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Grupi nismëtar I lëvizjes “Po për Shqipërinë” “I mbështetur nga Deputeti Z. Dashmir Shehu po paraqet projektligjin e hartuar për miratim në Kuvend.

Neni 81, pika 2/ç. “Miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit:... ç) ligji për referendumet;.....” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Nga analiza ligjore e bërë nga ekspertët e grupit nismëtar të lëvizjes “Po për Shqipërinë”, është konstatuar mungesa e një ligji specifik për referendumet. Kjo mungesë është vënë re në momente specifike kur pavarësisht opinionit public kundër, vendimmarrjet e pushtetit ekzekutive qëndror apo vendor kanë qënë arbitrare, të tilla si rasti i shëmbjes së Teatrit Kombëtar apo depozitimi i plehrave të rrezikshme në Shqipëri, Ndërtimi I Hidrocentraleve në Vjose, Valbonë etj. Mungesa e këtij projektligji ka çenuar të drejtën e popullit për të shprehur opinionin e tij dhe marrjen e një vendimi të njëanshëm në lidhje me çështje të tilla që kanë një rëndësi kombëtare.

Pjesa e 11 - Neni 150, 151 dhe 152 "Referendumi" I Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Projektligji është hartuar në përputhje të plotë me kufizimet ligjore që vendosin këto nen në lidhje me çështjet e përcaktuara në pikat e tij.

Projektligji "Për referendumet" ka si qëllim kryesor përcaktimin e normave dhe rregullave të përgjithshme për ndërmarrjen e iniciativës për referendum dhe administrimin e procesit në tërësi deri në shpalljen e rezultateve referendare, të cilat vijnë në ndihmë të përpjekjes për të maksimizuar procesin e demokratizimit në Shqipëri.

Në brendësi të projektligjit "Për referendumet" gjenden referencat përkatëse materiale dhe procedurale të Kodit Zgjedhor, që lidhen drejtpërdrejtë me referendumet si kombëtare ashtu edhe vendore .

Në projektligj janë përcaktuar qartë llojet e referendumeve, duke i klasifikuar në 2 kategori:

"Referendum në shkallë Republike" është referendumi që zhvillohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ka si objekt të tij një çështje të rëndësishme kombëtare, që ka të bëjë me pranimin ose refuzimin e një Kushtetute të re, për ndryshimet kushtetuese, për një çështje të rëndësishme së veçantë, për çështje të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe politike, ose çështje të tjera si mirë- përdorimi/administrimi i pasurisë publike, burimeve ujore dhe/ose pasurive natyrore, çështje mjedisore, të shëndetit publik.

"Referendum vendor" është referendumi, ku banorët e një njësie të qeverisjes vendore, bashki apo qark, shprehen me votim të drejtpërdrejtë për çështje që konsiderohen me rëndësi për komunitetin dhe që janë nën juridiksionin dhe autoritetin vendimmarrës të njësisë të qeverisjes vendore ku ata banojnë.

Ndërsa përsa i takon iniciativës për ndërmarrjen e referendumit, projekt ligji , lejon që kjo iniciativë të vij si nga komuniteti dmth nga poshtë – lartë, ashtu edhe nga institucionet qëndrore apo vendore dmth nga lartë-poshtë. Kjo mënyrë dyfishe e ndërmarrjes së iniciativës zgjeron bazën dhe njekohësisht diversifikon edhe llojshmeritë e referendumeve.

Projekt ligj përcakton qartë përgjegjësitë midis palëve në procesin e referendumit . Kështu grupi iniciator i referendumit është përgjegjës për ndjekjen e procedurave deri në dorëzimin e kërkesës për referendum. Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve është përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjithë procesin referendar deri në nxjerrjen e rezultatit, ndërsa qeveria qëndrore apo lokale është përgjegjëse për faturën financiare të referendumit.

Një element shumë i rëndësishëm në projektligj është përcaktimi i numri të nevojshëm të qytetarëve për të ndërmarrë nismën për referendum. Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë , neni 150, pika 1 thuhet: *Populli, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, ka të drejtën e referendumit për shfuqizimin e një ligji, si dhe t'i kërkojë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë*". Sipas ndarjes territoriale në Shqipëri ka 61 bashki, nga të cilat 20 Bashki kanë një popullsi nën 20 mijë banorë . Sipas INSTAT sot në Shqipëri jetojnë rreth 2.8 milion banorë të grup moshave të ndryshme. Në analizë të këtyre shifrave shohim se 1/3 e bashkive nuk mund të aplikojnë referendume për çështje të ndryshme vendore sepse

Kushtetuta kërkon 50.000 shtetas me të drejtë vote. Në këto kushte apriori referendumet vendore janë të paaplikueshme në më shumë se ½ e territorit të Shqipërisë cka çënon në mënyrë të drejtpërdrejtë ushtrimin e të drejtës për tu shprehur me votë dhe për të ndikuar në vendimmarje të rëndësishme.

Mbeshtetur në arsyetimin e mësipërm grupi nismëtar “Po për Shqipërinë” , në projekt ligj ka vendosur nenin 6 “Nisma për të zhvilluar një referendum” , ku thuhet “ Nisma për të zhvilluar një referendum në shkallë Republike duhet të firmoset nga shtetas shqiptarë me vendbanim brenda ose jashtë territorit të Shqipërisë, që plotësojnë numrin e votave të zgjedhjes së një deputeti në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, në raport me pjesëmarrjen e fundit në zgjedhjet qendrore. Nisma për të zhvilluar një referendum vendor duhet të firmoset nga qytetarët e qytetit apo qarkut përkatës, me vendbanim brenda ose jashtë territorit të Shqipërisë, që plotësojnë numrin e votave” . Ky nen duhet të shoqërohet domosdoshmërisht edhe me ndryshim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 150), sepse zhvillimet demografike në Shqipëri dhe rritja e mundësisë për mobilitet brenda dhe jashtë vendit nga viti 1998 kur është miratuar Kushtetuta dhe deri më sot kanë ndryshuar. Ky ndryshim duhet reflektuar edhe në Kushtetutë në mënyrë që projektligji i propozuar të implementohet edhe për referendumet vendore.

Projekt ligji është propozuar nga nisma “Po për Shqipërinë” e cila e ka konsultuar këtë projekt me grupe të interesuar nëpërmjet tryezave të konsultimeve me prezence dhe online, deri në krijimin e draftit përfundimtar. Projekt propozimi reflekton të gjitha ndryshimet e rena dakort midis grupeve të interesit dhe ka qëndruar për një kohë të gjatë në platformën online “Po për Shqipërinë”.

Dashamir Shkëlzi
Shkëlzi